



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

Numri i lëndës: 2021:207583
Datë: 21.05.2024
Numri i dokumentit: 05713943

E.nr.749/2

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, me gjyqtarin Faton Ajvazi dhe sekretaren juridike Makfire Reçica, duke vendosur në çështjen juridike përmbartimore të kreditorëve: F.Sh., R.H., N.Q. dhe N.Z. të cilët i përfaqëson av Qëndrim Reçica nga Lipjani, kundër debitorit Komuna e Shtimes -Drejtoria e Arsimit, për pagesën të procedurës, më datë 13.05.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

PËRFUNDON procedura përmbartimore në lëndën **E.nr.749/23**, për shkak të përmbushjes së kërkesës së kreditorit.

A r s y e t i m i

Gjykata Themelore në Ferizaj, me aktvendimin E.nr.749/23, të datës 27.03.2023, e ka caktuar përmbartimin e propozuar nga i autorizuari i kreditorit, kundër debitorit Komuna e Shtimes -Drejtoria e Arsimit, për pagesën për shpenzime të udhëtimit, ushqimit, pagave jubilarë dhe shpenzimeve të procedurës, në bazë të pajtimit gjyqësor 2021:207583 të datës 08.12.2022.

Meqenëse aktvendimi mbi lejimin e përmbartimit është bërë i formës së prerë dhe i ekzekutueshëm, gjykata me aktvendimin e datës 11.04.2024, e ka urdhëruar Thesarin e Kosovës pranë Ministrisë së Financave, Punës dhe të Transfereve, që nga llogaria e debitorit ta transferoj shumën e përgjithshme të mjeteve prej 9,144.60 euro , në llogarinë e të autorizuarit të kreditorit.

Meqenëse kreditorët e kanë realizuar kërkesën e tyre, Gjykata konstatoj se janë përmbushur kushtet ligjore nga neni 66, par 4, të LPP-së, dhe vendosi që ta përfundoj procedurën përmbartimore në këtë çështje juridike përmbartimore.

Nga sa u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ
E.nr.749/23 më datë 21.05.2024

GJYQTARI
Faton Ajvazi